



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:093057
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05382716

KE.nr.323/23

GJYKATA KOMERCIALE - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike civile të paditësit ‘‘Mobile Dekor’’ Sh.P.K., me numër unik identifikues 810198392, me seli në Komunën e Pejës, e të cilën e përfaqëson B.Z., nga Komuna e Pejës, e të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati F.B., me seli të zyrës në Pejë, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve ‘‘Elsig’’, Zyra Qendrore në Prishtinë, për shkak të padisë për zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, jashtë seancës me datë 27.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit ‘‘Mobile Dekor’’ Sh.P.K., me numër unik identifikues 810198392, me seli në Komunën e Pejës, e të cilën e përfaqëson B.Z., nga Komuna e Pejës, e të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati F.B..

A r s y e t i m

Paditësi, ‘‘Mobile Dekor’’ Sh.P.K., përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur padi kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve ‘‘Elsig’’ për zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, me të cilën

ka kërkuar që e paditura të detyrohet të paguajë kompensimin e dëmit material si pasojë e aksidentit të datës 21.03.2023 e të cilat i ka parashtruar në padinë e datës 24.03.2023.

I autorizuari i palës paditëse, përmes parashtrësës së datës 23.02.2024 ka parashtruar kërkesë për tërheqje të padisë, me arsyen se në mes të palëve është arritur marrëveshja jashtëgjyqësore andaj edhe konform me nenin 261 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, e tërheqë padinë dhe ka kërkuar që çështja në këtë procedurë të përfundohet.

Andaj, gjykata në vështrim të dispozitave të nenit 261 të Ligjit për procedurën Kontestimore (LPK), pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, jashtë seancës me datën 27.02.2024 ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi nga deklaratimet e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit kuptohet që pala nuk ka interes juridik për ta trajtuar këtë çështje me tutje në gjykatë.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.323/23, datë 27.02.2024

Gjyqtari:

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.